



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No. 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 2193 Nr. i faq./Br.st/No. pg. 382
Data/Datum/Date 26/5/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

NJOFTIM

Për mbajtjen e takimeve publike me Grupin e grave-buxhetimi gjinor, me bizneset dhe OJQ

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, kryetari i Komunës, Smajl Latifi organizon takime publike me qytetarë për kërkesat e tyre dhe ecurinë e projekteve me: **Grupin e grave-buxhetimi gjinor, me bizneset dhe OJQ**

Duke e pasur parasysh përkushtimin për përmbushjen e kërkesave të qytetarëve, Kryetari i Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi përdor mekanizma të këshillimeve dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në takime, për vlerësimet dhe propozimet për çështje të interesit të tyre.

Duke qenë pjesë e këtyre takimeve, ftojme qytetarët të japin kontributin e tyre!

Tema e takimeve: Kërkesat e tyre dhe ecuria e projekteve për vitin 2022.

Takimet mbahen në:

1	Grupi i grave-buxhetimi gjinor	Objekti SHPG "Hareja	3.6.2022	11:00
2	Takim me biznese	Salla e Kuvendit Komunal-Rahovec	3.6.2022	14:00
3	Takimi me OJQ	Salla e Kuvendit Komunal-Rahovec	3.6.2022	15.30

Jeni të mirëpritur!

